

ADING SHIRIT BUTILI

Shirit vetëngjites me filc poliesteri për ngjitjen e nyjeve kritike gjatë hidroizolimit

FUSHA E APLIKIMIT

Shirit mbështjellës për sigurimin e nyjeve kritike në hidroizolim. Përdoret në kryerjen e hidroizolimit me hidroizoluesit Hydromal, Hydromal Flex, Hydromal Flex 1K, Adingflex dhe hidroizolues të tjerë me bazë rrëshire sintetike. Shiriti vendoset në fuga pune, çarje, thellime më të vogla të instalimeve, lidhëse ndërmjet rrafshve vertikale dhe horizontale në rrjetet sanitare dhe kuzhinat. Vendoset midis shtresës së parë dhe të dytë të mbështjelljes hidroizoluese.

CILËSI

- ngjitje (adezion i) e mirë në nënshtresa(baza) të ndryshme
- ndjek sipërfaqe jo të rrafshëta
- shiriti pranon bojë, suva, çimento dhe ngjitëse
- fleksibilitet i përhershëm
- i thjeshtë dhe konciz për instalim
- rezistent ndaj këputjes
- rezistent ndaj ujit

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

CILËSITË	METODA	VLERA E DEKLARUAR
Adezion gjatë prerjes	H 15	12 N/cm ²
Adezion në temperaturë prej 90°C	H 48	8
Adezion në 180°C	H 41	9
Dendësia	H 6	1,60
Lëshimi i avullit	ISO 9932 / BS ISO 15106	0,18 g/m ² /24h/mm
Qëndrueshmëria e temperaturës	-	- 40°C deri +90 °C

METODOLOGJIA E REALIZIMIT

PËRGATITJA E SUBSTRATIT(BAZËS)


Shiriti aplikohet në një shtresë hidroizolimi të tharë më parë, të kryer në një nënshtresë betoni, llaç çimentoje, ose pllaka gipskartoni. Baza e hidroizolimit duhet të jetë e shëndoshë, e pastër, e fortë, pa plasartije a pjesë të paqëndrueshme, shtresa ekzistuese të lyera, yndyrë dhe pluhur. Temperatura gjatë vendosjes së shiritit të gomave duhet të jetë midis +5°C dhe +40°C.

Faqja 1 nga 3

VENDOSJA

Shiriti vendoset manualisht. Hiqet folia mbrojtëse dhe pastaj vendoset shiriti duke shtypur drejtpërdrejt në sipërfaqe.

Shiriti duhet të vendoset pas 6-24 orësh nga hedhja e shtresës së parë të hidroizolimit, varësisht nga temperatura.



PAKETIMI

Produkti është i paketuar në rolne me letër mbrojtëse, me përmasa 0.80 x 100mm dhe gjatësi 10m dhe 20m.

RUAJTJA

Produkti ruhet në paketimin origjinal në vend të freskët pa lagështi.

AFAI I PËRDORIMIT: 24 muaj.

Rreziku për shëndetin: Produkti nuk klasifikohet si i rrezikshëm sipas nenit 31 dhe aneksit 2 të rregullativës REACH të BE-së. Nëse gjëlltitet, kërkoni ndihmë mjekësore.

Mbrojtja: Gjatë instalimit të shiritit butil Ading, nuk kërkohet mbrojtje e sistemit të frymëmarrjes. Gjithashtu, nuk kërkohen as pajisje mbrojtëse për lëkurën dhe duart. Nëse produkti përdoret shpesh ose për një periudhë më të gjatë kohore, duhet të mbahen doreza mbrojtëse. Pas vendosjes, është e domosdoshme larja e duarve dhe shmangia e kontaktit me sytë.

Kontakti me sy: Në rast kontakti të produktit me sytë, lajini sytë me ujë. Kërkoni kujdes mjekësor nëse për kohë më të gjatë shfaqet iritim i syve. Lani menjëherë me ujë të bollshëm për 15 minuta. Hiqni lentet(thjerrat) kontaktuese dhe hapni sytë gjerë. Kërkoni ndihmë mjekësore nëse shfaqet ndonjë ndjenjë e pakëndshme.

Kontakti me lëkurën: Fshihuni dhe lahuni me sapun dhe ujë. Kërkoni ndihmë mjekësore nëse shfaqet iritim.

Inhalimi: Dilni në ajër të pastër. Kërkoni ndihmë mjekësore nëse shqetësimi nuk pushon.

Informacionet e dhëna në këtë prospekt teknik janë marrë nga testet dhe përvojat laboratorike. Karakteristikat e dhëna janë tipike dhe nuk janë të specifikuara. Në krahasim me përmasat dhe variacionet e nënshtresave(bazave), ne rekomandojmë që produkti të testohet nga përdoruesi për të përcaktuar përshtatshmërinë për një aplikim konkret.